

Njoftim: Mundësi punësimi si Operator i shërbimit ndaj klientit

Pozicioni: Operator i shërbimit ndaj klientit

Orari: Turn i dytë ora 16:00

Arsimi: Preferohet arsim I lartë

Kërkesat për Pozicionin

- Të ketë njohuri të gjuhës angleze.
- Preferohet të ketë njohuri dhe eksperiencë mbi sistemin e pagesave elektronike, apo në kompani me profil të ngjashëm.
- Njohuri të mira mbi paketën Office 2010.
- Të ketë përkushtimin e duhur në punë dhe përgjegjshmërinë si dhe të jetë i gatshëm të punojë në grup.

Detyrat Kryesore:

- T'i përgjigjet telefonatave dhe e-maileve që vijnë në drejtim të shërbimit të klientit.
- Merr porositë e ndryshme nga rrjeti i agjentëve.
- Kontakton me klientët për problemet e ndryshme që ata reklamojnë, orienton zgjidhjen e tyre në departamentet përkatëse.
- Kryen njoftimet e ndryshme te klientët për ndryshimet e procedurave të punës etj.
- Mban kontaktet me klientët.
- Monitoron procesin e porosive dhe pagesave dhe bashkëpunon ngushtë me gjithë departamentet përgjegjëse deri në konfirmimin e pagesës elektronike dhe dërgimin e porosisë.
- Monitoron procesin e shërbimit të transfertave duke udhëzuar klientët dhe agjentët që e ofrojnë shërbimin.

Dokumentacioni : CV-të e aplikimeve të dërgohen me e-mail në adresën: hr@easypay.al. Afati i aplikimeve 5 Janar 2022.

**Do të lajmërohen për intervistë vetëm kandidatët që do të përzgjidhen mbi bazën e CV-ve të mbërritura*

